

## UDHËZUES PËR ANËTARËT E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME

### Përshkrimi i Kursit

Në dritën e Reformës së Sektorit të Ujit 2022 të nisur nga Qeveria Shqiptare, e cila fokusohet në rajonalizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, shoqëritë rajonale ujësjellës kanalizime (UK) tashmë operojnë nën struktura të ndryshme qeverisëse. Rrjedhimisht, ekziston një nevojë urgjente për trajnime të mëtejshme për të siguruar që anëtarët e bordit mbikëqyrës të këtyre shoqërive rajonale UK mund të përmbushin në mënyrë efektive rolet e tyre. Ky kurs trajnimi është krijuar për të rritur njohuritë dhe aftësitë e individëve të emëruar në bordin mbikëqyrës të një shoqërie rajonale UK. Qëllimi i trajnimit është pajisa e pjesëmarrësve me mjetet dhe njohuritë e nevojshme për të adresuar sfidat e përditshme të drejtimit dhe për të kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së kompanisë.



Kursi i trajnimit synon të zgjerojë njohuritë e pjesëmarrësve për kompleksitetin dhe përgjegjësitë që lidhen me mbikëqyrjen e shoqërive UK. Trajnimi mbulon tema të ndryshme, duke përfshirë strukturën organizative dhe funksionimin e shoqërive ujësjellës kanalizime, ligjet dhe rregulloret përkatëse që ndikojnë në menaxhimin dhe funksionimin e shoqërisë, rolin e rregullatorit ekonomik në licencimin dhe miratimin e tarifave, dhe përdorimin e mjeteve dhe metodologjive për monitorimin e performancës së shoqërisë. Përveç kësaj, pjesëmarrësit do të fitojnë njohuri për zhvillimin dhe zbatimin e planeve të biznesit për të mbështetur menaxhimin dhe mbikëqyrjen efektive. Nëpërmjet mbulimit të këtyre aspekteve kritike, kursi i trajnimit synon të fuqizojë anëtarët e bordit mbikëqyrës për të marrë vendime të informuara, për tu orientuar në kornizat rregullatore dhe për të kontribuar efektivisht në suksesin dhe qëndrueshmërinë e shoqërive rajonale UK.

### Grupi i Synuar

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për individët që janë emëruar si anëtarë të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë UK, administratorët të

shoqërive ujësjellës kanalizime, si dhe çdo individ të interesuar për shërbimet ujësjellës kanalizime në Republikën e Shqipërisë.

### Objektivat e Kursit të Trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë të aftë të:

- Kenë njohuri mbi organizimin dhe funksionet e organeve drejtuese brenda shoqërive UK, duke përfshirë kuadrin ligjor që i rregullon ato.
- Kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë e Administratorit të Shoqërisë UK dhe procedurat e përcaktuara në ushtrim të aktivitetit të tij.
- Kenë njohuri mbi elementet bazë të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe funksionin që këto elementë kryejnë në ofrimin e shërbimeve UK.
- Kuptojnë rolin dhe funksionet e Entit Rregullator të Ujit dhe kuadrin rregullator që drejton veprimtarinë e tij.
- Kuptojnë aspektet institucionale, ligjore dhe rregullatore që ndikojnë në organizimin dhe menaxhimin e shoqërive UK.
- Kuptojnë konceptet bazë për hartimin e planeve pesëvjeçare të biznesit të përshtatura për shoqëritë UK.
- Mësojnë rreth mjeteve dhe metodologjive të përdorura për të monitoruar performancën e shoqërive UK.
- Kuptojnë potencialin e pjesëmarrjes së sektorit privat në ofrimin e shërbimeve UK dhe rritjen e performancës së shoqërive UK.

### Metodat e Trajnimit

Trajnimi është i bazuar në prezantime të shkurtra në PowerPoint, të ndërthurura me diskutime. Përveç prezantimeve, pjesëmarrësit do të angazhohen në diskutime dhe ndarje eksperiencash me kolegët për të përforcuar njohuritë.

### Materialet e Kursit të Trajnimit

Pjesëmarrësit në këtë kurs trajnimi, do të pajisen me një kopje elektronike të Manualit të Trajnimit "Udhëzues për Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Ujësllës Kanalizime". Përpos kësaj, pjesëmarrësit do të pajisen me certifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen në trajnim.

### Tarifa e Regjistrimit

- Anëtarët e SHUKALB: 29,900 lekë/person + TVSH
- Jo-anëtarët: 34,900 lekë/person + TVSH

Kjo tarifë përfshin materialet e trajnimit, drekat, dhe pushimet për kafe.